

LIGJËRIMI POLITIK DHE PUBLIK MBI INTEGRITETIN NË POLITIKË

Raport monitorimi prill-maj 2022

Instituti i Studimeve Politike

Stafi i Instituti i Studimeve Politike (ISP) kreu monitorimin e ligjërimit politik të reflektuar në raportimet e medias gjatë periudhës prill - maj 2022, si pjesë e projektit “Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur” mbështetur nga NED (National Endowment for Democracy).

Monitorimi u shtri në të gjitha mediat kryesore televizive (TCH, Klan TV, Vizion Plus, News 24, Ora News, A2, Abcnews, etj), kryesisht në qëndrimet editoriale dhe në lajmet kryesore të ditës. Gjithashtu u monitoruan portalet kryesore, si dhe mediat e shkruara Panorama, Gazeta Shqiptare, Shekulli dhe Dita.

Gjetjet kryesore të raportit monitorues (II, 2022)

- Raporti për dekriminalizimin dhe Integritetin në Politikë për periudhën prill-maj 2022 nxjerr në pah diferencën midis bazës ligjore, deklarimeve publike të institucioneve dhe të politikës, si dhe nivelit ende kritik të zbatimit integral të ligjit dhe të reformimit real të institucioneve përfaqësuese.
- Ligjërimi publik dhe politik mbi dekriminalizimin dhe standarde të munguara të integritetit në vendimmarrje, ka vijuar të jetë temë dominuese në raportimet mediatike dhe një tregues sa i brishtësisë së institucioneve aq edhe i ndikimit të lartë i lidhjeve informale midis krimit e politikës, i nivelit të lartë të korrupsionit, si dhe i pritshmërive më të larta sesa mundësitë për vendosjen e drejtësisë dhe fundin e pandëshkueshmërisë.
- Tipari i ndryshimit të ligjeve në funksion të problemit afatshkurtër apo interesave ditore vijon të jetë tipar dallues. Sa herë në legjislacion shfaqen probleme e vështirësi, zgjidhja nuk kërkohet në lexim integral të ligjit dhe sens përgjegjësie, por në klauzola penguese dhe për pasojë, në propozime për amendime ligjore, të cilat përveç se marrin kohë dobësojnë edhe vetë funksionalitetin e ligjit. E njëjta praktikë u ndoq edhe në ligjin e dekriminalizimit, i cili në thelb parandalon emërimet abuzive në poste publike e politike, por në praktikë klauzolat teknike dhe leximi i ndryshëm i ligjit ka krijuar probleme të mëdha dhe përfshirje të individëve me rekorde kriminale e korruptive në nivele të larta të vendimmarrjes, përfshirë parlamentin, ekzekutivin, sistemin e drejtësisë, të administratës shtetërore dhe publike, etj.

- Partitë politike e kanë shfrytëzuar ligjin për dekriminalizimin për të akuzuar njëra tjetrën për individët me rekorde kriminale, por në të njëjtën kohë partitë kanë bërë shumë pak për të larguar nga radhët e tyre individët që kanë rekorde kriminale. Partitë politike nuk i kanë reflektuar parimet e ligjit të dekriminalizimit në statutet e tyre dhe aktet e tjera rregullatore brenda partive dhe nuk kanë krijuar një sistem të qartë e efikas parandalimi. Ky veprim i qëllimshëm, u jep të drejtë individëve me rekorde kriminale të vijojnë të ruajnë postet në asamblatë kombëtare, degët lokale dhe në drejtimin politik të partisë, pra të influencojnë indirekt edhe në jetën politike.
- Relativizimi i reformës në drejtësi dhe procesi i dekriminalizimit është kthyer në një debat edhe mes qeverisë, opozitës dhe faktorit ndërkombëtar. Gjatës periudhës së monitorimit kryeministri Rama kritikoi dhe madje sulmoi ashpër për njëanshmëri politike deri në kërcënim punën e SPA, duke kërkuar publikisht masa ligjore ndaj përfaqësuesve të opozitës. Deklaratat e tij u përsëritën edhe nga drejtues të tjerë të lartë të mazhorancës dhe media mbështetëse. Akuza ndaj drejtësisë kanë ardhur edhe nga opozita, Presidenti dhe media pranë tyre, për të njëjtat qëllime, por me adresim të kundërt, duke i akuzuar për favorizim dhe ndikim nga mazhoranca. Deklaratat e qeverisë, opozitës, presidentit dhe vetë SPAK morën vëmendje maksimale gjatë dy muajve të monitorimit. (Shih deklaratimet e detajuara në raportin e plotë bashkëngjitur).
- Temat e dekriminalizimit, integritetit në politikë, politikanëve “non grata” dhe në listën e sanksioneve amerikane, si dhe akuzat për lidhje të politikës me krimin apo të përfshirjes në korrupsion, kanë qenë temat dominuese të raportimeve mediatike mbi zhvillimet politike në periudhën prill - maj 2022. Kulmimi i tyre ndodhi me vendimin amerikan për të vendosjes sanksione ndaj një politikani të lartë me ndikim në parlament dhe një pronari mediesh.
- Temë tjetër dominuese në media ishte interpretimi i ndryshëm i prioriteteve ndaj dekriminalizimit nga partitë politike dhe vlerësimet e ndryshme për të njëjtat raste. Për shembull, për qeverinë dhe PS prioritet u bënë qëndrimet politike kundër ish kryeministrit Berisha të shpallur “non grata”, duke deklaruar ndalimin e çdo bashkëpunimi politik dhe parlamentar me të, pavarësisht nivelit të tij të përfaqësimit në parlament, si dhe sulmet ndaj LSI dhe ish drejtuesve të PD për korrupsion. Nga ana tjetër PD zyrtare vijoi akuzat ndaj z. Berisha dhe z. Rama si dhe formacioneve të tyre mbështetëse duke këmbëngulur në vettingut në politikë, kurse vetë ata u akuzuan nga media e politikanë të ndryshëm për përfshirje në raste korruptive. LSI vijoi denoncimet ndaj qeverisë, ndërkohë që partitë e tjera më të vogla patën rol minor në debatin politik dhe publik mbi këtë çështje.

- Lidhur me përgjegjësitë, PS i konsideron përgjegjësi personale rastet e zyrtarëve të saj të lartë të përfshira në akte korruptive ose ndalim nga dekriminalizimi, ndërkohë që opozita nuk ka pasur qëndrime në rastet e akuzave ndaj individëve brenda saj. Media ka pasqyruar qëndrimet politike, por në tërësi fryma e medias ka qenë kritike ndaj partive politike dhe përpjekja për të larguar përgjegjësinë e tyre në lidhje me dekriminalizimin dhe skandalet financiare. (Shih deklaratimet e detajuara në raportin e plotë bashkëngjitur).
- Mediat i dhanë jehonë deklaratimeve të palës amerikane dhe evropiane lidhur me rëndësinë e dekriminalizimit të politikës dhe të qëndrimeve kritike ndaj personave të përfshirë në listat “non grata”, por nga ana tjetër, mediat u rreshtuan në favor të qëndrimeve politike të palëve, pa arritur të krijojë një sistem presioni të së mirës dhe interesit publik ndaj partive politike, sjelljes, kandidatëve dhe krizave të brendshme të tyre. Mediat në përgjegjësi, sidomos portalet online, më shumë u shndërruan në shtojca të tribunave politike të palëve rivale në PD dhe më pas, palëve rivale në skenën politike, sesa informuan publikun dhe ndikuan në krijimin e një mjedisi dekurajues për politikanët e inkriminuar ose të korruptuar. (Shih rastet specifike në raportin e plotë bashkëngjitur).
- Si në çdo vit, edhe këtë tre mujor të cilin po e marrim në shqyrtim një tipar tjetër i dukshëm i retorikës politike dhe publike, dhe bashkë me to, edhe i raportimeve mediatike, ishte tendenca e zyrtarëve përgjegjës në qeverisje për ta përdorur dekriminalizimin dhe nevojën e integritetit në politikë si mjet politik për të denigruar dhe atakuar rivalët politikë, gjë që në çdo rast krijon paqartësi në publik, sjell politizim të debatit dhe pamundëson shanset për një hetim serioz të fakteve, të dhënave dhe përgjegjësive të të akuzuarve apo të akuzuesve.
- Problematika themelore mbeten jo vetëm reagimet e dobëta institucionale por edhe kapja e medias. Figura të caktuara politike apo nga elita e biznesit shqiptar prej kohësh ruhen brenda një 'hermetizmi' mediatik. Televizionet e mëdha dështuan në raportimet e sakta për aferën e inceneratorëve dhe politikanëve të lidhura me to. Pronarë mediash kanë lidhje të forta ekonomike dhe politike, lidhje nepotike dhe fisnore. Raporti i OSBE/ODIHR bëri rekomandime të caktuara edhe për lirinë e mediave në vend, ku një faktor kyç kishte edhe presioni nga pronarët dhe drejtuesit e këtyre mediave. Gjithashtu pjesë e këtij raporti janë edhe një sërë gjyqtarësh dhe prokurorësh të cilët nuk 'preken' kurrë nga mediat në vend ose nga media të caktuara për shkak të lidhjeve të forta që ekzistojnë mes tyre dhe favoreve për të cilat ata janë të detyruar të ndërveprojnë.